



VENDIM

Nr. 73 Datë 13.06.2012

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE “PËR MIRATIMIN E STUDIMIT TË
BORXHIT TË KEQ”**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe në respektim të vendimit nr. 5690, shpallur ne datën 04.06.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me “Anullimin e vendimit nr. 99, date 30.09.2012, “Mbi miratimin e Studimit të Borxhit të Keq“, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 13.06.2012, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

Konstatoi se:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 5690 shpallur me date 4 Qershor 2012, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë së shoqërisë CEZ Shperndarje sh.a duke anuluar vendimin nr. 99 date 30.09.2011, “Per miratimin e Studimit mbi Borxhin e Keq”.
- Ministira e Financave në cilësinë e Garantuesit sipas Marreveshjes së Mbeshtetjes Qeveritare (PRG), me shkresat nr.4512/3 Prot, date 5.04.2012, dhe nr. 4512/7 date 12.06.2012, duke konsideruar kuadrin ligjor respektiv, rekomandimet dhe korrespondencat me Banken Botërore minimizimin e riskut të ekspozimit të vendit ndaj proceseve gjyqësore vendore dhe ndërkombetare si dhe për të garantuar furnizimin pa ndërpreje me energji elektrike ka mbështetur propozimin e Bankes Botërore për rikonsiderimin e Borxhit të Keq dhe niveleve perkatese të tij sipas supozimeve të studimit, por duke përjashtuar subjektet buxhetore dhe si të tilla edhe supozimet e ERE-s.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e Studimit të Borxhit të Keq.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë CEZ Shpërndarje sh.a për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI